



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "REXHA SHPK" për aktivitetin: "Tregu I ri I qytetit" dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511 nxjerr:

### VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "REXHA SHPK" e datës 13.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu I ri I qytetit" dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 12.11.2020.
3. Ky vendim i korigjuar hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "REXHA SHPK" me datë 13.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Tregu i ri i qytetit**", dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.11.2020 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Te gjitha pretendimet e paraqitura në kete kerkese janë trajtuar në kërkesat paraprake dhe poashtu janë trajtuar edhe nga komisioni i rivlerësimit, mirëpo do ti cek shkurt edhe disa sqarime:

-Eshte konstatuar se dëshmia për vinç nga tenderuesi i rekomanduar për kontrate është kërkuar pa pasë dëshmi as në tender e as si mjet i paraqitur në liste, mirëpo kjo ka ndodhur dhe nuk ka efekt të kthehemi në vlerësimin e pare. Kjo mund të jete siqe e quani ju e paligjshme, mirëpo tani nuk mund të riparohet;

-Lidhur me pretendimet tuaja per kualifikimet e stafit(inxhinieri e elektros)ju sqaroj se kam kërkuar sqarime plotësuese nga komisioni edhe pas dorëzimit te rekomandimit,por ata e konsiderojnë si devijim te vogël dhe e bëjnë si anëtar te pranueshëm te stafit:dhe

-Te gjitha pretendimet tuaja dhe sqarimet e dërguara nga Instituionet tjera i kam percjellur me kohe dhe kame kërkuar trajtim nga te njëjtit dhe pergjegjet e tyre janë si pjese e rekomandimit te tyre përfundimtar.

Nga kjo rrjedh se une nga pozita ime i kam percjellur te gjitha kërkesat tuaja te komisioni i rivlerësimit dhe ata si komision profesional i kane trajtuar si te pamjaftueshme qe ju te jeni tenderues i përgjegjshëm dhe ne kete menyre përgatitja ime profesionale me ka detyruar te pajtohem me rekomandimin e tyre dhe te njëjtin e kam aprovuar.

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.**

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Vendimi i dërgohet:**

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njësisë së kërkesës.

**Zekë Bardhaj**  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

